RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Blerina Huruglica *Eksperte Shqyrtuese*	04.04.2022	14.04.2022	*83/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.04.2022 **OE"ARITECH SHPK" ,** ka parashtruar ankesë me nr. **83/22** kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull:"**Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative",** me nr. të prokurimit: **216-22-656-5-5-8**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë për Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 35.000,00

Data e njoftimit për kontratë.....09.02.2022.
Hapja e ofertave.....18.02.2022.
Data e njoftimit mbi anulimin e vendimit të AK-së..... .....22.03.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....24.03.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....25.03.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE

Dispozitat e shkelura

AK ka shkelur gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

Neni 52

Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

1. Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

3. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Autoriteti Kontraktues me date 24.02.2022 kerkon nga Aritech shpk para publikimit te njoftimit te vendimit dokumentet si ne vijim:

Prandaj, kërkojmë që *para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK*, të dorëzoni këto dokumente :

- **Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje).**
- **Vërtetimin nga Gjykata Themelore**-Departamenti për Çështje Ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të operatorit ekonomik (kërkohet origjinal ose i vërtetuar/noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).
- **Formën origjinale të sigurimit të tenderit,** që e keni ngarkuar në platformën elektronike Eprokurimi me rastin e ofertimit.

në adresën: rr: "Luan Haradinaj", pn, Ndërtesa e MPJD-se,Kati i X nr. 1005, Prishtinë.

Pa përgjigjen nga ana e juaj për dëshmitë e kërkuara të lartë shënuara. deri më **29.02.2022 në** orën **12:00**, tenderi juaj **do të refuzohet**.

Pas dorezimit te dokumenteve me lart ne me date 22.03.2022 kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e AK-se si njoftimin mbi anulimin e procedures se prokurimit.

Autoriteti kontraktues anulon proceduren e prokurimit me arsyetimin si ne vijim:
Citojme:

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, **anulon**[1] aktivitetin e prokurimit, arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik: pas hapjes së tenderëve bëhet mbështetur në nenin 62 të LPP-së pika 1, alinea 1.1.

1.1. *një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.*

Për shkak të mjeteve buxhetore me rastin e inicimit të procedurës, janë planifikuar ne kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, kurse nga ofertat e pranuar vlera e pajisjeve është ma e vogël se 1,000.00 € për njësi dhe pas marrjes se opinionit ne MFPT ne lidhje me mundësitë për transferim të mjeteve nga kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale ne Mallra dhe Shërbime, nga divizioni i buxhetit dhe financave kemi marrë njoftim se nuk mund te autorizoj me tutje si procedure sepse nuk ka mjete te planifikuara për procedurën e njëjte ne kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime, MPJD detyrohet të anulojë këtë tender dhe ta ri tenderojë me një afat me të shkurtër kohor, në përputhje me kategorinë mjeteve buxhetore në dispozicion.

Arsyetimi qe vlera e pajisjeve eshte ma e vogel se 1,000.00 per njesi eshte i pakuptueshem per neve si OE pjesemarres me çmim me te lire ne kete aktivitet te prokurimit.

Nese e bejme nje analize te thjeshte na del rezultati si ne vijim:

Ne kete aktivitet te prokurimit jane kerkuar 35 cope PC Model I, 35 cope Monitor Model I dhe 8 cope Laptop Model I.

Buxheti per kete aktivitetet te prokurimit eshte parashikuar ne vlere 35,000 euro.

Ne te tri pozicionet e kerkuara na del qe sasia eshte 78 cope pajisje.

Ne kete rast sipas arsyetimit te anulimit nenkupton qe planifikimi per kategorine ekonomike Shpenzime kapitale do te duhej te ishte minimum 78,000 euro.

Sidoqofte nuk eshte detyre e OE-ve as te percaktojne e as te dijne lidhur me kategorite ekonomike te Autoriteteve kontraktuese.

Kriteret percaktohen ne dosje te tenderit.

Shih printscreen Kriteret sipas dosjes se tenderit:

NENI VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS – VLERËSIMI I TENDERIT

VI.1) Kriteret për dhënien e KONTRATËS

Kontrata do ti shpërblehet operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët

VI.2) VLERËSIMI I TENDERIT

Tenderët e pranuar **me kohë** do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të kërkesave të parashtruara në këtë FPO. Tenderi konsiderohet të jetë i **përgjegjshëm** kur është në përputhje me të gjitha kërkesat e kësaj FPO. Tenderët e **përgjegjshëm** do të vlerësohen dhe krahasohen sipas **kriterit për dhënien e kontratës** të përcaktuara në NENIN VI.1. Tenderuesi i cili ka dorëzuar tenderin e renditur më së larti do te shpërblehet me kontrate. Në rast se jo të gjithë Operatorët Ekonomikë që janë palë të Kontratës Publike kornize dorëzojnë ofertat e tyre, procedura e mini-tenderimit do të jetë e vlefshme.

Siç mund te shihet me lart kriter per kete aktivitet te prokurimit eshte tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet. Aritech shpk eshte operatori ekonomik i pergjegjshem dhe me çmimin me te lire.

Perveç kritereve te percaktuara ne dosje te tenderit, te cilat detyrohemi t'i permbushim, tjera kritere te papercaktuara ne dosje nuk eshte detyre e as mundesi te percaktojme e as ndryshojme.

Ne baze te kesaj besojme qe AK duhet te percaktoje ne dosje te gjitha kriteret, perderisa eshte detyre e OE-ve plotesimi apo permbushja e kritereve perkatese.

Tjeter gje e pakuptueshme ne vendimin e Autoritetit kontraktues eshte qe pas anulimit AK do ta ritenderoje me nje afat me te shkurter kohor, **ne perputhje me kategorine e mjeteve buxhetore ne dispozicion.**

Si ka mundesi qe me te njejten kategori ekonomike-shpenzime kapitale siç po nenkuptohet, me kushtin qe duhet te blihen produkte me çmime te kategorise shpenzime kapitale 1000+ euro perderisa **mjetet buxhetore ne dispozicion** jane per Shpenzime kapitale, duke pas parasysh qe produktet e kerkuara nuk tejkalojne çmimin njesi 1000 euro per njesi.

Duke u bazuar ne argumentet me larte kerkojme nga Organi juaj shqyrtues qe te merr vendim si ne vijim:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE "ARITECH SHPK" lidhur me tenderin "Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative**"**

ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-se "**Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës"** si dhe Vendimi mbi letren standarde mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit**,** tenderi të Rikthehet ne Rivleresim.

AK-së, të i kërkohet që vendimin te marr ne perputhje me kriteret e percaktuara ne dosje te tenderit.

KRITERET PËR VLERËSIM

/

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Autoriteti Kontraktues anulon aktivitetin e prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE

Sqarim hyrës: Aktiviteti i prokurimit me titull**" Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative"** nga kontrata kornizë e lidhur me **AQP me nr: UA/216-19-9628-1-1-1,** ku autoriteti kontraktues **Ministria e Jashtme dhe e Diasporës** kanë dërguar kërkesë për ofertim tek operatorët ekonomik, duke vazhduar tutje me vlerësim të ofertave, dhe me datë **24.02.2022 AK** fillimishtë ka rekomanduar OE ankuesin duke i kërkuar që ti sjellin dëshmitë e pranueshmërisë. Me datë 22.03.2022 AK e anulon aktivitetin me arsyetimin që mjetet nuk janë të destinuara sipas kategorisë përkatëse dhe se nuk mund të ndrrohet kategoria sipas rekomandimeve të cilat i kanë marrë nga MFPT.

Tutje OE ankuesi, pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, me datë 01.04.2022 parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka të drejtë të anuloj aktivitetin e prokurimit dhe se ka shkelë nenin 52 të LPP-së.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimeve të OE ankuesit të parashtruara në ankesë, dhe pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, fillimishtë kërkon sqarim me shkrim nga autoriteti kontraktues, duke kërkuar që të dëshmohet komunikimi me divizionin kompetent.

Wed 4/13/2022 11:18 PM

Blerina Huruglica

Kërkesë për sqarim -Minitender nr:216-22-650-5-5-8

To Shefkinaze Vllasaliu

Cc OSHP; Shqipe Hoti

E nderuara znj. Shefkinaze Vllasaliu,

Sic biseduam edhe në telefon,

Jemi duke e shqyrtuar ankesën e **OE ankues Aritech SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "**Furnizimi me pajisje të Teknologjisë Informative**", ku pretendimet e të njejtit janë kundër anulimit të aktivitetit.

Andaj, ju lutem na sqaroni arsyen e anulimit duke na bashkangjitur komunikimet me MFPT-në dhe Divizionin për buxhet dhe financa, sic e keni potencuar edhe në njoftimin mbi anulimin e aktivitetit, meqë nuk janë si dëshmi në E-prokurim!

Me shpresë se do të përgjigjeni sa më shpejtë që është e mundur,

Mbetëshi me shëndet,

Me respekt,
Blerina Huruglica
Ekspert Shqyrtues
Organi Shqyrtues i Prokurimit
Prishtinë

Përderisa AK është përgjigjur menjëherë duke bashkangjitur dëshmitë lidhur me arsyen e anulimit.

Kërkesa e AK-së për ndryshim të kategorisë:

From: Mizbah Mustafa
Sent: Friday, March 11, 2022 2:15 PM
To: Bashkim Mehmetaj
Cc: Behar Isma; Milaim Aliu
Subject: Kërkesë

I nderuar z. Mehmetaj,

Ju drejtohem me kërkesën për mundësit e trasferit të mjeteve nga kategora e Shpenzimeve Kapitale në kategorinë Mallra dhe Sherbime brenda organizatës sonë.

Më konkretisht, kërkesa jonë do të bazohej në mundësinë e transferit të mjeteve nga kodi Kompjuter në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale, në kategorinë Mallra dhe Shërbime në programin e "Administratës Qendrore".

Duke kërkuar mirëkuptimin Tuaj,

Gjithë të mirat,

Mizbah MUSTAFA,
Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa
Ministria Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Përgjigja nga departmenti i MFPT-DB:

From: Bashkim Mehmetaj
Sent: Monday, March 14, 2022 11:31 AM
To: Mizbah Mustafa <Mizbah.Mustafa@rks-gov.net>
Cc: Behar Isma <Behar.Isma@rks-gov.net>; Milaim Aliu <Milaim.Aliu@rks-gov.net>
Subject: RE: Kërkesë

I nderuar

Kjo çështje duhet te trajtohet me planifikimin buxhetor, ose me rishikimin e buxhetit për vitin 2021.

Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj te vazhdueshëm

Me respekt
Bashkimi MFPT - DB

Si dhe përgjigjja nga Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa:

To Shefkinaze Vllasaliu
Cc Behar Isma
Retention Policy DelFiveYOldEm (5 years) Expires 3/14/2027
You replied to this message on 3/21/2022 2:41 PM.

E nderuar znj. Vllasaliu,

Ju shkruaj ne lidhje me autorizimin e kerkeses se disponueshmerise per proceduren e prokurimit "Blerja e Kompjutereve" e cila si planifikim eshte bere ne kategorine ekonomike Shpenzime Kapitale.

Meqenese si procedure, sipas jush, ka kaluar ne kategorine ekonomke Mallra dhe Sherbime ne me pak se 1000 per njesi, dhe pas marrjes se opinionit ne MFPT ne lidhje me mundesite e transferit te mjeteve nga kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale ne Mallra dhe Sherbime, dua te ju njoftoj se une nuk mund te autorizoj me tutje si procedure sepse nuk ka mjete te planifikuara per proceduren e njejte ne kategorine ekonomike Mallra dhe Sherbime.

Mirembetshi,
Mizbah MUSTAFA,
Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa

Si përfundim, sa i përket aktivitetit të prokurimit në fjalë, përderisa çmimet për njësi janë nën vlerën 1000 euro, atëhere kjo procedurë duhet të kategorizohet në mallra dhe shërbime, gjerësa AK mjetet e planifikuara i ka nga destinimi i shpenzimeve kapitale, dhe si rrjedhojë ky aktivitet meqë nuk ka planifikim të buxhetit nuk mund të kaloj nga kategoria në kategori tjetër pa u bërë rishikimi i buxhetit, dhe si e tillë aktiviteti i prokurimit anulohet.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE **"Aritech"SHPK** të refuzohet si e pa bazuar, dhe se vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - **Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës**

Panelit Shqyrtues - **OSHP**

OE ankues - "**Aritech"SHPK**